



UDHËZUES PËR VLERËSIMIN DHE ADRESIMIN E RREZIQEVE QË LIDHEN ME KEQPËRDORIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT NË DHUNËN NË FAMILJE

GENDER AND SALW CONTROL: KNOW HOW SERIES

1 Treguesit e ndërhyrjeve me rrezik të lartë

2 Marrja e një raportimi për dhunë në familje

3 Vlerësimi i rreziqeve

4 Ndërhyrja dhe sigurja

5 Zhvillimet pas incidentit

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit rajonal *Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor (IPA/2021/425-067)*, me financimin e Komisionit Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, përmes Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni:

Drejtuesin e SEESAC

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000 Beograd, Serbi

Tel: +381 11 415 5300

www.seesac.org

Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë: Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian, për sa i përket: 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tij.

Redaktorët: Jasminka Frishchikj, eksperte kryesore dhe Dragan Božanić, Specialist i projektit të SEESAC për hulumtimet dhe çështjet gjinore

Përkthimi: Alba Global

Dizajni dhe faqosja: Ivan Čulafić

Printimi: Bigraf Plus, Beograd

Qarkullimi: 50 copë

Vendi dhe viti i lëshimit: Beograd, 2024

ISBN-978-86-7728-367-4

@ SEESAC 2024. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

UDHËZUES
PËR VLERËSIMIN
DHE ADRESIMIN
E RREZIQEVE QË
LIDHEN ME
KEQPËRDORIMIN E
ARMËVE TË ZJARRIT
NË DHUNËN
NË FAMILJE

Falënderime

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për profesionistët e shumtë që kontribuan në zhvillimin e Udhëzuesit, ku bëjnë pjesë:

Ekspertët: Jasminka Friscikj (Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, eksperte kryesore), Kosana Beker (Femplatz), Elona Dini (UNDP Shqipëri), Maja Branković Đundić (UNDP Serbi).

Anëtarët e Grupit të Punës dhe përfaqësuesit e departamenteve për trajtimin e dhunës në familje: Snežana Vujović, Aleksandar Marković, Alma Hot, Dejan Bogavac, Behar Ramadani, Zylfije Dema, Milazim Govori, Siniša Kosarić, Enes Softić, Slobodan Janković, Ankica Dimovska, Aleksandra Deckovska, Nenad Milenkovski, Dhurata Mehmeti, Eriselda Dollani, Hike Cara, Paško Pehar.

Përfaqësuesit e Ministrive të Brendshme dhe Policisë që morën pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit: Elsa Zylyftari, Agron Pod Gega, Fatma Kalemi, Reshat Kalaci, Kastriot Gjongecoj, Julian Cano, Silvia Binaj, Tajar Hysenaj, Adeva Kondi, Dhurata Mehmeti, Elena Hasanago, Erba Leka, Eriselda Dollani, Lindita Lushaku, Oldian Lici, Valbona Rrapaj, Miroslav Kosić, Hrvoje Pašalić, Jasmina Čunjalo, Antonija Kovačević, Amir Kuko, Kristijan Kraljević, Kalila Hrgić, Krešimir Kosić, Muamer Bajrović, Edin Musić, Samela Ribo, Zvonimir Brnić, Agron Maliqi, Bajram Ademi, Lorita Bejtullahu-Preteni, Ramadan Ahmeti, Sami Hasanaj, Sefer Muhadim, Blerim N. Krasniqi, Milazim Govori, Behxhet Krasniqi, Esat Maliqi, Mukadese Gogolli-Maloku, Shemsie Jonuzaj, Xhemile Behluli, Mirjana Cvetkovska, Emilija Damcevska, Dean Stamatovski, Nermine Izairi, Tatjana Gjurovska, Demiralija Fejzo, Biljana Jakimovska, Stefan Mihajlovic, Violeta Trpcevska, Aleksandra Deckovska, Zulfi Abdulli, Burim Ademi, Nenad Dejanoski, Selman Selmanovski, Nikola Gjorgjevski, Astrit Aslani, Snežana Vujović, Alma Hot, Danijela Rajević, Dejan Bogavac, Ermila Vujošević, Jasminka Luboder, Bosiljka Palikuća, Biljana Vukčević, Dragana Jovičević, Dragica Kalezić, Jovana Nišavić, Ranka Jovanović.

Përfaqësuesit e organizatave të grave dhe ofruesit e shërbimeve në rajon që morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve: Aurela Bozo, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Marsela Allmuça dhe Marinela Muçobega, Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri”, Mersida Male (Bashalliu), Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Stela Tanellari, “Të ndryshëm & Të barabartë”, Anjeza Bojaxhiu, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) për rastet e dhunës në familje, Bashkia e Tiranës, Amra Beganović, “Medica Zenica”, Mersiha Lokvančić, Fondacioni i Demokracisë Vendore, Radmila Žigić dhe Mirzeta Tomljanović, Fondacioni “Lara” në Bjeljina, Gorica Ivić dhe Andrea Buzadžija, Fondacioni “Gratë e Bashkuara”

në Banja Luka, Elmedina Sejdiu, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Elena Dimushevaska, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Natasha Petkovska, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Jasna Orovcanec Arangelovik, Shoqata e Avokatëve të Rinj në Maqedoni (MYLA), Leonora Dukaj, "Safe life Tuzi", Nataša Međedović dhe Nada Koprivica, "Numri i ndihmës për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës Nikshiq", Nada Jelovac, Tijana Vuksanović dhe Jovana Mirković, "Sigurna ženska kuća", Zorica Konatar, "Qendra për të Drejtat e Grave".

Përmes konsultimeve dhe vlerësimit mes ekspertëve, përfaqësuesit e organizatave të grave, si: "Numri i ndihmës për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës Nikshiq", "Safe Women's House" Podgoricë, Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri" Tiranë, Fondacioni "Gratë e Bashkuara" Banja Luka dhe Fondacioni "Lara" Bjeljina, kanë kontribuar në zhvillimin e Udhëzuesit.

Skuadra e SEESAC e cila kontribuoi në hartimin e Udhëzuesit: Alain Lapon, Kryekëshilltar Teknik, Juliana Buzi, Koordinatore për Bashkëpunim Rajonal, Vesna Cipruš, Këshilltare e Lartë për Çështjet Gjinore, Tatjana Višacki, Analiste Projekti, Violeta Gaši, Bashkëpunëtore e Programit dhe Jana Ilić, Asistente e Programit.

Contents

1.	Hyrje	6
1.1	Procesi i zhvillimit të udhëzuesit	8
1.2	Armët e zjarrit si faktorë rreziku në kontekstin e dhunës në familje	8
1.3	Përse na nevojitet ky Udhëzues?	15
Kutia 1:	Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" dhe vlerësimi i rrezikut	16
2.	Përmbledhje e Udhëzuesit	17
2.1	Objektivi i Udhëzuesit	17
2.2	Kujt i shërben ky Udhëzues?	18
2.3	Parimet	18
2.4	Përmbajtja e Udhëzuesit	19
Hapi 1:	Treguesit e ndërhyrjeve me rrezik të lartë	21
Hapi 2:	Marrja e një raportimi për dhunë në familje	25
Hapi 3:	Vlerësimi i rreziqeve	29
A)	Autori ose një tjetër anëtar i familjes zotëron armë në mënyrë të ligjshme	30
B)	Autori ose një tjetër anëtar i familjes zotëron armë në mënyrë të jashtëligjshme	31
Kutia 2:	Teknologjitë e reja - Printimi 3D	33
C)	Autori ka akses në armë zjarri si pasojë e detyrës së tij dhe është i trajnuar për përdorimin e tyre	34
D)	Autori kërcënon me përdorimin e armës	34
E)	Treguesit vizualë të zotërimit të (jashtë)ligjshëm të armëve të zjarrit	34
Kutia 3:	Kontrolli i mediave sociale dhe aktivitetit në internet	36
Hapi 4:	Ndërhyrja dhe siguria	39
A)	Garantimi i sigurisë personale dhe sigurisë së viktimave	40
B)	Sigurimi dhe mbledhja e gjurmëve të akteve kriminale dhe e armëve të zjarrit	41
C)	Konfiskimi i armëve të zjarrit	41
D)	Armët e zjarrit në zotërim të jashtëligjshëm	42
E)	Prania e lëndëve plasëse dhe e pajisjeve shpërthyes	43
Hapi 5:	Zhvillimet pas incidentit: Procedurat lidhur me armët e zjarrit	45

1. Hyrje

1.1 Procesi i zhvillimit të udhëzuesit

Në kuadër të projektit rajonal “Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor”, të financuar nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, përmes Udhëzuesit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), SEESAC po ofron mbështetje për autoritetet në Ballkanin Perëndimor për të integruar perspektivën gjinore në masat për kontrollin e AVL-ve. Në këtë kontekst, zbatohet një grup aktivitësh gjithëpërfshirëse për të përmirësuar përgjigjen institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Për të forcuar kapacitetet institucionale për gjetjen dhe vlerësimin e duhur të rreziqeve që lidhen me praninë dhe përdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, SEESAC inicioi zhvillimin e një Udhëzuesi për punonjësit e policisë lidhur me vlerësimin dhe reagimin ndaj rreziqeve të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje. Për të hartuar Udhëzuesin, por edhe për të kryer një analizë rajonale mbi armët e zjarrit dhe dhunën në familje, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe drejtorinë e policisë në Ballkanin Perëndimor, në vitin 2022, SEESAC inicioi ngritjen e një Grupi Rajonal pune për parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

Takimi i parë i Grupit të Punës u organizua në Podgoricë, më 23-24 nëntor 2022. Në takim u mblodhën përfaqësues nga departamentet që trajtojnë dhunën në familje dhe nga departamentet e analizës nga pesë juridiksione të Ballkanit Perëndimor: Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup dhe Tiranë.¹ Gjatë takimit, grupi i punës shqyrtoi metodologjinë për analizën rajonale lidhur me armët e zjarrit dhe dhunën në familje, diskutoi sfidat kryesore në parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, si dhe nisi zhvillimin e Udhëzuesit për të vlerësuar dhe adresuar rrezikun e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

¹ Duke qenë se autoritetet në Beograd kanë zhvilluar tashmë udhëzues të ngjashëm me mbështetjen e UNDP-së në Serbi përmes projektit *Redukto rrezikun-Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje*, përfaqësuesit e Serbisë nuk morën pjesë në aktivitetet e Grupit të Punës, por i paraqitën Grupit të Punës mësimet e nxjerra dhe praktikatat e mira të zhvilluara në kuadër të këtij projekti, të cilat janë integruar në këtë Udhëzues.

Për të shqyrtuar rreziqet në një mënyrë gjithëpërfshirëse u organizuan pesëmbëdhjetë (15) fokus grupe për të marrë kontribute lidhur me hartimin e tij dhe për të diskutuar mënyrat e përshtatshme të trajtimit të rreziqeve të lidhura me praninë e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje. Fokus grupet u realizuan në Sarajevë nga data 21 deri në 23 mars; në Tiranë nga data 28 deri në 30 mars; në Podgoricë nga data 4 deri në 6 Prill; në Prishtinë nga data 12 deri në 14 prill; dhe në Shkup nga 25 deri në 27 prill. Në çdo juridiksion u organizuan tri fokus grupe: me përfaqësues të organizatave të grave (morën pjesë në total 17 organizata), me oficerët e policisë që merren me miratimin e lejeve për armë zjarri (33) dhe me oficerët që u përgjigjen rasteve të dhunës në familje (35). Në vijim të diskutimeve të grupeve të fokusit, u zhvilluan 15 raporte gjithëpërfshirëse që kontribuuan në zhvillimin e Udhëzuesit.

Takimi i dytë u zhvillua në Durrës, në datat 23-25 maj 2023. Gjatë takimit treditor, anëtarët e grupeve të punës trajtuan gjetjet kryesore nga diskutimet e grupeve të fokusit dhe diskutuan në detaje shqetësimet kryesore dhe masat për parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Bazuar në të dhënat nga Grupi i Punës, praktikat e mira ekzistuese në rajon, si dhe gjetjet nga grupi i fokusit, SEESAC zhvilloi një draft të Udhëzuesit, i cili përcakton strukturën dhe përmbajtjen, si dhe nënvizon hapat kryesorë që duhet të trajtohen për të garantuar vlerësimin dhe adresimin e duhur të rreziqeve të lidhura me praninë e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

Gjatë nëntorit dhe dhjetorit 2023, SEESAC organizoi takime konsultuese me anëtarët e Grupit të Punës ku u prezantua drafti i Udhëzuesit. Gjatë këtyre takimeve, anëtarët paraqitën propozime se si mund të përmirësohet Udhëzuesi, veçanërisht nga pikëpamja e përdorimit praktik të tyre.

Konsultime u zhvilluan dhe me organizatat të cilat punojnë në sferën e të drejtave të grave dhe vajzave në mënyrë që të shqyrtohen më tej masat e propozuara në Udhëzuesi nga pikëpamja e sigurisë së të mbijetuarave nga dhuna në familje.

Krahas kontributeve të vlefshme nga Grupi i Punës, instrumenti përfiton nga një gamë e gjerë praktikash të mira në këtë fushë, duke përfshirë nga produktet e njohurisë të zhvilluara në kuadër të projektit *Redukto rrezikun-Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje*, të zbatuar nga UNDP në Serbi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit që u realizua për të mbështetur zhvillimin e Udhëzuesit.

1.2 Armët e zjarrit si faktorë rreziku në kontekstin e dhunës në familje

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit vazhdon të përbëjë një kërcënim serioz ndaj sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve në Ballkanin Perëndimor, si të grave po ashtu edhe të burrave. Ai nxit dhunën në familje dhe krimin, si dhe cenon qëndrueshmërinë, duke penguar kështu zhvillimin e përgjithshëm.

Ndikimi i ndryshëm i keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë dhe burrat është i qartë dhe i mirëstudiuar. Burrat përbëjnë 99% të autorëve të incidenteve me armë zjarri. Ata përbëjnë gjithashtu shumicën e viktimave të incidenteve me armë zjarri, përkatësisht 81%, ndërsa gratë 19%. Burrat përbëjnë shumicën e personave që kryejnë vetëvrasje, veçanërisht me armë zjarri.

Pavarësisht se burrat janë më të rrezikuar nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit në mosmarrëveshjet dhe grindjet në publik, si dhe në kontekstet kriminale, gratë ndikohen në mënyrë joproporcionale nga përdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Njohuritë e dhura rreth zanafillës, dinamikës dhe shfaqjes së dhunës në familje, natyrës së saj me bazë gjinore dhe ndikimit të saj joproporcional te gratë, përbëjnë një parakusht thelbësor për parandalimin efektiv të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

Dhuna në familje¹

Dhuna në familje përbën formën më mbizotëruese dhe të përhapur të dhunës. Ajo përfshin të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes apo ambientit familjar, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve të mëparshëm apo aktualë, pavarësisht nëse autori ka jetuar ose jo në të njëjtën banesë me viktimën. Si gratë po ashtu edhe burrat mund të jenë viktimat e dhunës në familje, por ajo prek gratë në mënyrë joproporcionale. **Ajo dallon nga llojet e tjera të dhunës pasi gjinia e viktimës është motivi parësor për aktet e dhunës, pra dhuna ushtrohet ndaj një gruaje për vetë faktin sepse ajo është grua, ose i prek gratë në mënyrë më shumë joproporcionale.**

Dhuna me bazë gjinore është një vepër penale dhe përbën shkelje të të drejtave të njeriut, të drejtave të jetës, lirisë, sigurisë, dinjitetit, mosdiskriminimit dhe barazisë së grave dhe burrave, si dhe të integritetit fizik dhe shpirtëror.

Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe përfshin të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që çojnë, ose

mund të çojnë, në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimet për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngimin ose heqjen arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse ndodh në jetën publike ose private.

Modelet dhe zanafilla e viktimizimit të grave dhe burrave në kontekstin familjar dallojnë ndjeshëm. Në kontekstin familjar, gratë janë më të rrezikuara ndaj dhunës së ushtruar nga partnerët intimë, qoftë aktualë ose të mëparshëm, ndërsa burrat janë përgjithësisht të rrezikuar nga anëtarë të tjerë të familjes, kryesisht nga anëtarët e tjerë meshkuj. Dhuna ndaj burrave zakonisht nuk ka bazë gjinore dhe lidhet me mosmarrëveshjet familjare, problemet e pronësisë, dhunën e rrënjosur ndër breza etj.

Forma më ekstreme dhe më e rëndë e dhunës ndaj grave është **femicidi**, pra **vrasja e qëllimshme, me motive gjinore, e grave dhe vajzave. Femicidi është vrasja e një gruaje nga ana e një burri për shkak të urrejtjes ndaj grave, përbuzjes, kënaqësisë, ndjesisë së pronësisë dhe pushtetit mbi gratë.**

Dhuna në familje, veçanërisht dhuna nga partneri intim e ushtruar nga burrat, është një model sjelljeje që përdoret në çdo marrëdhënie që përdoret për të fituar ose ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partneren intime. Si e tillë, **dhuna në familje përbën gjithmonë abuzim të pushtetit dhe kontrollit nga autori.** Ajo karakterizohet nga një model veprimesh dhe sjelljesh abuzive që përdor një individ për të kontrolluar apo dominuar qëllimisht partneren e tij intime. Këto veprime përfshijnë kanosjen dhe kërcënimet, abuzimin emocional, izolimin, frikësimin, përdorimin e privilegjeve mashkullore² dhe të fëmijëve për të fituar dhe ruajtur kontrollin mbi partneren.

Shpeshherë, dhuna që ushtrojnë burrat ndaj grave justifikohet nga qëndrimet, normat dhe pritshmëritë sociale dhe kulturore, të cilat mbështesin përdorimin e dhunës nga burrat për të ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partneren ose ish-partneren e tyre. Studimet e kanë lidhur dhunën gjinore me pranimin social të dominimit mashkullor, me krijimin e stereotipave për rolet gjinore, si dhe me pranimin e dhunës si një mënyrë normale për të zgjidhur konfliktin. **Stereotipat gjinorë mund të nxisin dhunën ndaj grave, si dhe zotërimin dhe përdorimin e armëve dhe mbizotërimi i qëndrimeve që mbështesin zotërimin e armëve në komunitet mund të pengojë përpjekjet për reduktimin e rasteve të dhunës në familje që përfshijnë armë zjarri.**

2 Privilegjet mashkullore janë sistemi i avantazheve dhe të drejtave që disponojnë burrat si pasojë e gjinisë së tyre dhe bazohet në idenë dhe praktikën e dominimit të burrave ndaj grave. Duke nënshtruar sistematikisht gratë, burrat fitojnë avantazhe ekonomike, politike, sociale, arsimore dhe praktike, të cilat në përgjithësi nuk janë të disponueshme për gratë. Dhuna në familje mund të nxisë privilegjet mashkullore në shoqërinë e ditëve të sotme. Ajo përforcon pozitën e pushtetit që u atribuohet burrave, duke bërë kështu që gratë të vazhdojnë të vuajnë pasojat e saj. Privilegjet mashkullore rriten përmes mënyrave të objektivizimit të grave, si dhe përmes perceptimit se ato kanë rolin t'u shërbejnë nevojave të partnerëve të tyre meshkuj. Burrat mund ta marrin për të mirëqenë se u takon e drejta e ushtrimit të kontrollit ndaj grave. Një gjë e tillë krijon një ndjesi autoriteti që shfaqet në formën e kanosjes, ndëshkimit dhe taktikave të kontrollit (Burimi: [Dhuna në familje dhe privilegjet mashkullore](#)).

Rrallë ndodh që incidentet e dhunës në familje të jenë raste të izoluara dhe në përgjithësi, shpeshësia dhe ashpërsia e tyre përshkallëzohet dhe rrezikon të kulmojë në lëndime të rënda fizike ose edhe në vdekje. Për rrjedhojë, njohja e dinamikave dhe fazave të dhunës në familje është thelbësore për parandalimin e saj.

Qasjet ndaj parandalimit dhe ndërhyrjes duhet të marrin në konsideratë dinamikat komplekse të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si lloje të dhunës me bazë gjinore. Për këtë arsye, këto qasje duhet të ofrojnë mbështetje për viktimat në të gjitha fazat, si dhe duhet të fokusohen në identifikimin dhe parandalimin e përshkallëzimit të dhunës.

Shkalla e problemit

Anketa e udhëhequr nga OSBE¹¹ ka dokumentuar gjerësisht shkallën e problemit, duke përfshirë në Ballkanin Perëndimor, si dhe mbizotërimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave. 70% e grave të anketuara kanë përjetuar një formë të dhunës në një moment të caktuar pas moshës 15 vjeç, ndërsa 31% kanë përjetuar një formë të dhunës në 12 muajt para anketës. Pothuajse një e katërta e grave të anketuara (23%) kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner intim pas, ndërsa 60% kanë përjetuar dhunë psikologjike të ushtruar nga një partner intim. Pothuajse gjysma e grave kanë përjetuar të paktën një formë ngacmimi seksual dhe 10% e tyre janë përndjekur në një moment të caktuar. Kjo anketë ka dokumentuar edhe nivelin e ulët të raportimit të dhunës ndaj grave. Vetëm 7% e grave kanë kontaktuar policinë menjëherë pas incidentit më të rëndë të dhunës së ushtruar nga partneri aktual dhe 15% e tyre kanë kontaktuar policinë në rastet e dhunës së ushtruar nga ish-partneri.

Siç është dokumentuar nga [analiza](#) e SEESAC, vrasja e anëtarëve të familjes është forma më e përhapur e vrasjeve të grave në rajon. 61% e të gjitha grave të vrara në Evropën Juglindore (EJL), janë vrarë nga një anëtar i familjes, krahasuar me 12,4% të të gjithë burrave të vrarë. Gratë janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna nga partneri intim. Përkatësisht, 38,6% e të gjitha grave të vrara dhe 1,2% e të gjithë burrave të vrarë në EJL janë vrarë nga një partner intim.

Shpeshherë, armët e zjarrit janë mjeti i zgjedhur në kryerjen e dhunës në familje. Sipas studimit të kryer në rajon, 37,7% e vrasjeve të kryera nga anëtarët e familjes janë kryer me përdorimin e armëve të zjarrit dhe 43,5% e të gjitha grave të vrara nga një partner intim në Evropën Juglindore janë vrarë me armë zjarri.

Armët e zjarrit përdoren edhe si mjet për të shkaktuar forma të tjera të dhunës me bazë gjinore si dhuna fizike, psikologjike dhe seksuale, duke përfshirë përdhunimin dhe abuzimin seksual, lëndimin emocional, kanosjen, frikësimin, si dhe dhunën ekonomike.

Edhe pse këto forma të dhunës zakonisht pasohen nga ngjarje fatale, të dhënat vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme.

Analiza e fundit e SEESAC dokumentoi më tej praninë e vazhdueshme të dhunës në familje me armë zjarri dhe shkallën e saj. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, në Evropën Juglindore, numri i individëve të vrarë me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje ka qenë më i madh (101) se në çdo lloj tjetër incidenti, duke përfshirë ato në kontekstin kriminal (93), në mosmarrëveshjet në publik (93) dhe nga të shtënat për shkaqe të papërcaktuara (87).

Vrasjet e kryera me armë zjarri në Evropën Juglindore, sipas llojit të incidentit, gjinisë dhe vitit:

Lloji i incidentit	2019		2020		2021	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
Dhuna në familje	11	18	17	24	9	22
Konteksti kriminal	28	4	28	0	30	3
Mosmarrëveshjet në publik	33	1	26	0	33	0
Të shtënat për shkaqe të papërcaktuara	24	3	32	2	24	2

Nga 83 gra të vrara me armë zjarri në Evropën Juglindore, 64 prej tyre (77%) janë vrarë në kontekstin e dhunës në familje. Ndërkohë, për sa i përket burrave, nga 361 të vrarë me armë zjarri, 37 prej tyre (10%) janë vrarë në kontekstin e dhunës në familje. Në kontekstin e dhunës në familje, gratë ishin më të rrezikuara nga përdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë aktualë ose të mëparshëm. Pra, nga totali i grave të vrara me armë zjarri, 47 prej tyre (57%) janë vrarë nga partneri i tyre intim. Në të njëjtën periudhë, dy burra janë vrarë me armë zjarri nga partnerja intime. Gjithashtu, nga totali i personave të vrarë me armë zjarri, 17 gra (20%) dhe 35 burra (10%) janë vrarë nga anëtarë të tjerë të familjes, kryesisht të gjinisë meshkuj.

85% e të gjitha incidenteve janë kryer me armë zjarri në pronësi të jashtëligjshme. Megjithatë, **të dhënat e kufizuara mbi vrasjet e grave të kryera me armë zjarri konstatojnë përdorimin e armëve të zjarrit të zotëruara në mënyrë të ligjshme dhe të jashtëligjshme.**

Perceptimi i grave dhe burrave për armët e zjarrit lidhet ngushtësisht me dallimet në modelet e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen. Përqindja e grave që i perceptojnë armët e zjarrit si rrezik apo kërcënim ndaj sigurisë vetjake dhe të familjes, përkatësisht 39% dhe 61%, është shumë më e lartë se në rastin e burrave.

Të shtënat masive të kohëve të fundit në rajon, disa prej të cilave janë kryer me armë zjarri në pronësi të ligjshme, kanë pasur efekte shkatërrimtare dhe afatgjata te qytetarët, familjet dhe

komunitetet. Nuk është habi që 78%^{III} e qytetarëve të anketuar në Ballkanin Perëndimor në vitin 2023 u shprehën se ndiheshin të kërcënuar nga zotërimi dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit në ambientet përreth tyre, çka do të thotë se problemet e lidhura me armët e zjarrit zënë vendin e parë në listën e shqetësimeve të sigurisë në rajon.

Për më tepër, 72% e të anketuarve në Ballkanin Perëndimor^{IV} u shprehën se dhuna në familje përbën një rrezik serioz për sigurinë.

Armët e zjarrit si faktorë rreziku

Në kontekstin e dhunës në familje, prania dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e viktimave, si dhe të oficerëve të policisë që ndërhyjnë dhe personave të tjerë të përfshirë, duke përfshirë edhe vetë autorët.

Ekzistojnë disa rreziqe specifike të lidhura me armët e zjarrit, të cilat duhet të merren në konsideratë:

- ▶ Aksesueshmëria dhe zotërimi i armëve të zjarrit nga abuzuesit, në kontekstin e dhunës në familje, rrisin pushtetin dhe kontrollin e ushtruar nga abuzuesit ndaj viktimave, çka është qëllimi i tyre kryesor. Armët e zjarrit rrisin pabarazitë e pushtetit midis viktimës dhe autorit, nxisin pabarazinë gjinore dhe përforcojnë hierarkitë sociale që u japin burrave dominancë ndaj grave.
- ▶ Zotërimi i armëve të zjarrit nga abuzuesit përbën jo vetëm një mjet të fuqishëm për ushtrimin e kontrollit ndaj viktimave, por rrit gjithashtu rrezikun e lëndimeve të rënda ose të vrasjes.
- ▶ Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje është më fatal se në çdo lloj tjetër incidenti dhe është pothuajse katër herë më vdekjeprurës se sa në incidentet kriminale. 37,4% e incidenteve të raportuara të dhunës në familje, të cilat përfshinin armë zjarri, kanë pasur pasoja fatale ndërsa në kontekstin kriminal kjo shifër është 9,6%.
- ▶ Dhuna në familje ndodh më shpesh në ambientet e shtëpisë dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit në hapësira të tilla të mbyllura rrit pasojat e tyre vdekjeprurëse.
- ▶ Ka disa faktorë të tjerë të cilët rrisin mundësinë e pasojave fatale në rastet e dhunës në familje kur përfshihen armët^V e zjarrit:
 - mundësia e ulët që gratë të raportojnë dhunën,
 - plagët e rënda nga të shtënat me armë,
 - kapaciteti i ulët i viktimës për të bërë rezistencë,
 - shanset e pakta të viktimave për t'u arratisur ose të personave të jashtëm për të ndërhyrë dhe për t'i ndihmuar ato.
- ▶ Për shkak të pranisë së armëve të zjarrit, dhuna shpesh nuk raportohet në fazën

fillestare, por shumë më vonë, gjë që çon në pasoja edhe më të rënda për viktimat.

- ▶ Nëse armët e zjarrit janë të disponueshme, ka shanse më të larta që një abuzues t'i përdorë ato në rastet e dhunës në familje.
- ▶ Koha e largimit nga abuzuesi është veçanërisht e rrezikshme për një viktimë të dhunës në familje, pasi dhuna mund të përshkallëzohet. Nëse abuzuesi dyshon ose merr informacion se partnerja po planifikon ta lërë, ai mund t'i trembet faktit se mund të humbasë pushtetin dhe kontrollin. Për rrjedhojë, ekziston një tendencë për përshkallëzimin e sjelljes së dhunshme dhe rritet mundësia e përdorimit të armëve të zjarrit.
- ▶ Rreziku i dhunës nuk merr fund me raportimin e saj. Në këtë kontekst, rreziqet më të larta për viktimat, krahas të tjerave, lidhen me divorcin, vendimet për kujdestarinë e fëmijëve dhe gjetjen e një partneri të ri. Studimet e kryera^{VI} së fundmi në rajon lidhur me vrasjet e grave me armë zjarri treguan se periudha ndërmjet momentit të largimit nga autori dhe vrasjes së grave të larguara varionte nga disa ditë deri në dy vjet.
- ▶ Edhe kur armët e zjarrit nuk keqpërdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë, thjesht prania e tyre është një instrument efikas që e lejon abuzuesin të ushtrojë kontroll mbi viktimën.
- ▶ Ndonëse të dhënat e lidhura me keqpërdorimin e armëve të zjarrit disponohen kryesisht për vrasjet e grave, plagosjet dhe sulmet, armët e zjarrit përdoren më së shumti për kërcënime dhe frikësime. Armët e zjarrit përdoren edhe si mjet për të shkaktuar forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhunë psikologjike dhe seksuale, duke përfshirë përdhunimin dhe abuzimin seksual, lëndimin emocional, kanosjen, si dhe dhunën ekonomike. Edhe pse këto forma të dhunës zakonisht pasohen nga ngjarje fatale, raportimi i tyre vazhdon të jetë në nivele tejet të ulëta.
- ▶ Aksesit në armët e zjarrit që zotërohen nga anëtarë të tjerë të familjes apo persona të tjerë që jetojnë në të njëjtën shtëpi, përbën gjithashtu rrezik për keqpërdorimin e tyre në kontekstin e dhunës në familje dhe duhet të merret në konsideratë.
- ▶ Mundësia e pasojave fatale rritet nëse autori ka akses në armë zjarri si pasojë e profesionit dhe trajnimit të tij profesional. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, një në dhjetë (10 nga 101) persona të vrarë me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në Ballkanin Perëndimor janë vrarë nga një oficer policie ose nga një pjesëtar i personelit ushtarak.
- ▶ Prania e armëve të zjarrit të shërbimit në shtëpi, veçanërisht nëse nuk ruhen siç duhet, rrit shanset e keqpërdorimit të tyre në dhunën në familje dhe në rajon ka pasur raportime të rasteve të tilla.
- ▶ Ndonëse në kontekstin e dhunës në familje keqpërdoren si armët e zjarrit në zotërim të ligjshëm po ashtu edhe ato në zotërim të jashtëligjshëm, këto të fundit përbëjnë një rrezik specifik për shkak të mungesës së një mekanizmi për kontrollin e tyre.
- ▶ Të shtënat masive janë shumë shpesh të lidhura me dhunën në familje. Në rajon ka pasur disa raste kur të shtënat masive në publik janë paraprirë nga incidente të

dhunës në familje, duke përfshirë nga të shtëna në incidentet e dhunës në familje. Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje paraqet rrezik si për sigurinë e viktimave, po ashtu edhe për komunitetin më të gjerë.

- ▶ Në disa raste, ndaj autorëve të të shtënave masive janë ngritur më parë pretendime apo akuza për dhunë në familje, ose janë arrestuar për çështje të tilla. Janë raportuar gjithashtu raste kur arma e zjarrit i është kthyer autorit dhe është përdorur për të shtëna masive vetëm disa ditë më vonë.
- ▶ Vrasjet e grave me armë zjarri shpesh kryhen në ambiente publike, në afërsi të dëshmitarëve, duke vënë në rrezik sigurinë e tyre.
- ▶ Prania dhe keqpërdorimi i armëve të zjarri paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e oficerëve të policisë që marrin pjesë në operacionet e ndërhyrjes.
- ▶ Prania e armëve të zjarrit lidhet me një rrezik më të lartë të vetëvrasjes. Në familjet ku ushtrohet dhunë në familje, prania e armëve të zjarrit mund të rrisë rrezikun që viktimat, abuzuesit dhe madje edhe anëtarët e tjerë të familjes të kryejnë vetëvrasje.
- ▶ Fëmijët që jetojnë në familje ku ekzistojnë raste të keqpërdorimit të armëve të zjarrit janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të traumës që mund të ketë pasoja afatgjata në zhvillimin e tyre. Gjithashtu, ekziston rreziku që fëmijët të bien në kontakt me armën, çka mund të rezultojë në ndodhjen e aksidenteve.
- ▶ Disponueshmëria e armëve të fëmijët dhe të rinjtë rrit rrezikun e aksidenteve, vetëvrasjeve dhe dhunës ndërmjet të rinjve.
- ▶ Efektet traumatike të abuzimit me armë zjarri prekin jo vetëm viktimat, por edhe personat e tjerë të pranishëm, duke përfshirë fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes.
- ▶ Zotërimi dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje mund të jetë i lidhur me veprimtari të tjera kriminale, ku përfshihen trafikimi i armëve, drogës, apo krimi i organizuar.

Një analizë e kohëve të fundit mbi vrasjet e grave të kryera me armë zjarri në Serbi^{VII}, ka identifikuar se këto vrasje paraprihen nga disa faktorë me rrezik të lartë, si më poshtë: **largimi i viktimës nga autori** (68% e rasteve), **xhelozia nga ana e autorit** (63% e rasteve), **frika e viktimës nga autori apo frika se mund ta vrasin** (47% e rasteve), si dhe **përndjekja dhe ndjekja e viktimës nga autori** (26% e rasteve).

Në 4 nga 19 raste të vrasjeve të grave me armë zjarri, autorët kanë pasur akses në armët e zjarrit për shkak të punës së tyre në fushën e sigurisë, p.sh., rojtarë të tokave bujqësore, mbikëqyrës të veprimtarive sportive/të gjuetisë ose oficerë policie.

1.3 Përse na nevojitet ky Udhëzues?

Në vitin 2021, SEESAC realizoi një analizë gjinore në shkallë të gjerë të legjislacionit dhe politikave për kontrollin e armëve të vogla në Ballkanin Perëndimor, me qëllim vlerësimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë gjinore të këtij legjislacioni dhe politikave përkatëse. Analiza dokumentoi se janë ndërmarrë përpjekje të dukshme në mbarë rajonin për të garantuar se ligjet për armët parandalojnë përdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje. Kjo arrihet nëpërmjet ligjeve për armët, të cilat synojnë të kufizojnë aksesin e çdo aplikanti në armët e zjarrit në rast se ka precedentë të dhunës në familje, si dhe nëpërmjet ligjeve për mbrojtjen nga dhuna në familje, të cilat parashtrojnë një grup masash gjithëpërfshirëse për të përmirësuar parandalimin e dhunës në familje. Këto masa përfshijnë gjithashtu procedurat e vlerësimit dhe të menaxhimit të rrezikut.

Rreziku i menjëhershëm për dhunë në familje paraqet mundësinë që dhuna të ndodhë, të përsëritet dhe të përshkallëzohet. Rreziqet ndaj sigurisë me të cilat përballen viktimat vlerësohen rast pas rasti, në bazë të procedurave të standardizuara. Vlerësimi i rrezikut përfshin vlerësimin e rrezikut për pasoja vdekjeprurëse, seriozitetit të situatës dhe rrezikut për përsëritje të dhunës^{VIII}. Autoritetet përkatëse i menaxhojnë rreziqet e sigurisë të identifikuar në vlerësimin e rrezikut përmes aktiviteteve me në qendër viktimat (p.sh., planifikimi i sigurisë), me në qendër autorët (p.sh., përdorimi i kompetencave policore për të hetuar, zbuluar dhe ndaluar shkeljet) ose me në qendër viktimat dhe autorët së bashku. Objekti dhe lloji i aktiviteteve të ndërmarra duhet të bazohen te vlerësimi i rrezikut, të zbatohen brenda një kuadri ndërinstitucional, si dhe të monitorohen lidhur me efikasitetin e tyre. Këto aktivitete synojnë të reduktojnë kërcënimin që paraqet autori, si dhe të mbrojnë viktimën nga dhuna dhe abuzimi i mëtejshëm.

Procedurat e vlerësimit të rrezikut në Ballkanin Perëndimor i pranojnë, edhe pse në nivele të ndryshme, rreziqet e lidhura me armët e zjarrit në kontekstin e dhunës në familje. Vlerësimet e rrezikut marrin kryesisht në konsideratë zotërimin e një arme zjarri nga autori dhe nëse është keqpërdorur një armë zjarri në incidentin e raportuar, ndërkohë që aksesin në armët e zjarrit merret më pak në konsideratë.

Pavarësisht përpjekjeve të qarta për adresimin e rreziqeve të lidhura me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, të dhënat në dispozicion dokumentojnë praninë e vazhdueshme të dhunës në familje, duke përfshirë përdorimin e armëve të zjarrit në këtë kontekst.

Këto tendenca ngrenë alarmin për emergjencën që paraqet kjo problematikë. Në këtë aspekt, Grupi i Punës ka shqyrtuar në mënyrë të detajuar mënyrat e përmirësimit të mëtejshëm të procedurave ekzistuese të vlerësimit të rrezikut për të përfshirë të gjitha format e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje. Krahas adresimit të rrezikut që paraqesin armët e zjarrit në zotërim të ligjshëm dhe ato në zotërim të

jashtëligjshëm, Grupi i Punës e ka vënë theksin veçanërisht te sfidat e lidhura me keqpërdorimet e armëve të zjarrit në zotërim të jashtëligjshëm dhe tek identifikimi i tyre në kohën e duhur.

Kutia 1: Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe vlerësimi i rrezikut

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” e vë theksin te detyrimi për marrjen në konsideratë të rreziqeve që paraqesin armët e zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

Neni 51 – Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut

1. Palët marrin masat e nevojshme ligjore apo masa të tjera për të garantuar se të gjitha autoritetet përkatëse kryejnë një vlerësim të rrezikut të pasojave vdekjeprurëse, të seriozitetit të situatës dhe të rrezikut për përsëritje të dhunës, me qëllim menaxhimin e rrezikut dhe nëse është e nevojshme, ofrimin e sigurisë dhe mbështetjes së koordinuar.
2. **Palët marrin masat e nevojshme ligjore apo masa të tjera për të garantuar që vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 të marrë parasysh siç duhet, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, faktin nëse autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente zotërojnë ose kanë akses në armë zjarri.**

Paragrafi 2 e shtrin më tej detyrimin për të garantuar që vlerësimi i rrezikut i përmendur në paragrafin e parë të këtij neni të marrë parasysh siç duhet informacione të besueshme lidhur me zotërimin e armëve të zjarrit nga autorët. Zotërimi i armëve të zjarrit nga autorët jo vetëm që përbën një mjet të fuqishëm për ushtrimin e kontrollit mbi viktimat, por rrit gjithashtu edhe rrezikun e vrasjes. Kjo vlen veçanërisht në situatat pas konfliktit ose në kontekstin e ekzistencës së një tradite të zotërimit të armëve të zjarrit, çka mund të rrisë aksesin e autorëve në këto armë. Megjithatë, rastet tepër të rënda të dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje, të shkaktuara përmes përdorimit të armëve të zjarrit, ndodhin edhe në të gjitha kontekstet e tjera. Për këtë arsye, hartuesit e konsideruan thelbësore të parashikonin detyrimin që garanton se çdo vlerësim i rreziqeve me të cilat përballen viktimat merr sistematikisht në konsideratë, në të gjitha fazat e hetimit dhe të zbatimit të masave mbrojtëse, faktin nëse autori zotëron armë zjarri në mënyrë të ligjshme apo të jashtëligjshme, ose nëse ka akses në këto armë, me qëllim që të garantohet siguria e viktimave. Për shembull, gjatë lëshimit të urdhrave për nxjerrjen e autorit nga banesa, apo urdhrave të mbrojtjes në raste emergjence, si dhe në rastin e dhënies së dënimit pas shpalljes fajtor për çdolloj forme dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, Palët mund të miratojnë, brenda sistemeve të tyre të brendshme ligjore, masat e nevojshme për të mundësuar sekuestrimin/konfiskimin e menjëhershëm të armëve të zjarrit dhe municioneve.

2. Përmbledhje e Udhëzuesit

2.1 Objektivi i Udhëzuesit

Objektivi i këtij Udhëzuesi është të mbështesë oficerët e policisë që:

- ▶ të vlerësojnë,
- ▶ të adresojnë,
- ▶ të parandalojnë dhe të reduktojnë

me efikasitet rreziqet e lidhura me praninë dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje dhe në veçanti, të dhunës ndaj grave dhe rrjedhimisht, të kontribuojnë në rritjen e sigurisë së të mbijetuarave të dhunës në familje.

Duke mbështetur zbatimin efektiv të dispozitave ligjore dhe të prioriteteve strategjike, Udhëzuesi synon të kontribuojë në eliminimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe të rrisë sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe burrave në Ballkanin Perëndimor.

Udhëzuesi, i cili mbështetet në procedurat ekzistuese të vlerësimit të rrezikut, duhet të konsiderohet kryesisht si një ndihmë për profesionistët për të trajtuar më mirë rreziqet e lidhura me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje. Udhëzuesi synon të rrisë më tej efikasitetin e ndërhyrjeve, duke përfshirë vlerësimet e rrezikut, të realizuara nga oficerët e caktuar, pa pasur si qëllim zëvendësimin e procedurave ekzistuese standarde të veprimit. Ky Udhëzuesi ofron disa hapa lidhur me mënyrën e vlerësimit të detajuar të këtyre rreziqeve specifike të lidhura me armët e zjarrit, të adresimit të përshtatshëm të tyre, si dhe të garantimit të sigurisë së viktimave.

Udhëzuesi supozon se oficerët përgjegjës të policisë janë të njohur me procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe procedurat e tjera standarde të veprimit në juridiksionet e tyre përkatëse. Për rrjedhojë, Udhëzuesi nuk përmban listat e përmendura të vlerësimit të rrezikut, por fokusohet vetëm te roli i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje.

2.2 Kujt i shërben ky Udhëzues?

Udhëzuesi u drejtohet kryesisht oficerëve të policisë që veprojnë në rastet e dhunës në familje. Për më tepër, Udhëzuesi mund të jetë një instrumenti i dobishëm për të gjithë aktorët në parandalimin e dhunës në familje, si p.sh., qendrat për punë sociale, prokuroritë, gjykatat, mekanizmat e koordinimit (nëse janë ngritur), si dhe organizatat që ofrojnë shërbime të specializuara për viktimat e dhunës.

2.3 Parimet

Qasja e përgjithshme e këtij Udhëzuesi bazohet në respektimin dhe integrimin e plotë të parimeve gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe eliminimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Këto parime përfshijnë sa më poshtë:

- *Zero tolerancë ndaj dhunës, pra shoqëria nuk e pranon dhunën në familje, dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore apo sjelljet që e mbështesin atë,*
- *Prioriteti i të gjitha ndërhyrjeve është ndalimi i dhunës dhe garantimi i masave të tjera të mbështetjes dhe ndihmës për viktimat,*
- *Siguria e viktimës përbën prioritet në masat që merren nga shërbimet, institucionet dhe autoritetet,*
- *Miratimi i një qasjeje me në qendër viktimën dhe marrja në konsideratë e nevojave të shumta të viktimave, cenueshmërive të tyre dhe rreziqeve me të cilat përballen, si dhe e ndikimit që kanë tek to vendimet dhe masat e ndërmarra,*
- *Autori është përgjegjësi i vetëm për sjelljen e dhunshme,*
- *Pabarazia e pushtetit midis viktimës dhe autorit të dhunës duhet të merret në konsideratë në çdo ndërhyrje.*
- *Kur u përgjigjemi rasteve të dhunës duhet të merren në konsideratë aspekte të tilla si moshë, aftësitë e kufizuara, përkatësia etnike, orientimi seksual, identiteti gjinor, vendbanimi (urban ose rural) dhe ekspozimi ndaj varfërisë, sepse këto aspekte mund të ndikojnë ndjeshëm në format dhe shkallën e ekspozimit ndaj rrezikut të dhunës në familje.*

2.4 Përmbajtja e Udhëzuesit

Udhëzuesi përfshin një grup **listash kontrolli praktike** që synojnë të ndihmojnë oficerët e policisë për të vlerësuar siç duhet rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, në zotërim të ligjshëm dhe të jashtëligjshëm, në dhunën në familje, si dhe për të reaguar me shpejtësinë e duhur ndaj këtyre rreziqeve.

Bazuar në këtë qasje, instrumenti ofron një përmbledhje të masave të lidhura me armët e zjarrit që duhet të ndërmerren në çdo hap të procedurave të policisë:



HAPI 1:

Treguesit e ndërhyrjeve me rrezik të lartë

Me qëllim planifikimin efikas të ndërhyrjes, oficerët e policisë në detyrë dhe ata që marrin pjesë në një ndërhyrje duhet të jenë të njohur me treguesit e ndërhyrjeve me rrezik të lartë në kontekstin e dhunës në familje, veçanërisht kur përfshihen armët.

Nëse identifikohet ndonjë nga treguesit e mëposhtëm, ndërhyrja duhet të planifikohet në mënyrë të përshtatshme. Prania e këtyre treguesve paraqet mundësinë e një ndërhyrjeje me rrezik të lartë dhe duhet të trajtohet me urgjencë dhe kujdes maksimal.

Treguesit e ndërhyrjeve me rrezik të lartë përfshijnë incidentet/ngjarjet në të cilat:

- ▶ Autori zotëron ose ka akses në një armë zjarri, pavarësisht nëse kërcënon ose jo se do ta përdorë atë,
- ▶ Ka të dhëna se autori i krimit mund të posedojë në mënyrë të paligjshme armë zjarri,
- ▶ Autori kërcënon se do të përdorë armë zjarri, duke përfshirë edhe vetëvrasjen,
- ▶ Është përdorur një armë zjarri në një incident të raportuar më parë,
- ▶ Një person është plagosur rëndë, i është rrezikuar jeta apo ka humbur jetën,
- ▶ Viktimat apo personat e tjerë (zakonisht fëmijët) përballen me një rrezik imediat (situatë pengmarrjeje), në veçanti nëse përfshihen armë zjarri,
- ▶ Dhuna është e vazhdueshme, veçanërisht nëse ekzistojnë raporte të mëparshme për dhunë në familje,
- ▶ Autori ka akses në armë për shkak të profesionit dhe ka kryer trajnim profesional për përdorimin e tyre (p.sh., është oficer policie ose pjesëtar i personelit ushtarak, apo një punonjës i një institucioni tjetër që lejohet të mbajë armë, si p.sh., i Shërbimit të Inteligjencës, Policisë Gjyqësore, doganave, shërbimeve korrigjuese, apo rojtar i pyjeve, punonjës sigurie i bankave, ose kurator muzeu etj., punonjës i një shoqërie private të sigurisë, punonjës në dyqan armësh zjarri, punonjës i shërbimit të mbrojtjes së tokave bujqësore apo mbikëqyrës i veprimtarive sportive/të gjuetisë),
- ▶ Autori është dënuar më parë për çdo formë krimi apo kundravajtjeje që ka të bëjë me dhunën.

Rreziqet përshkallëzohen nëse autori është në gjendje të dehur apo nën ndikimin e lëndëve psikoaktive, ka probleme të shëndetit mendor, duke përfshirë gjendjet e pa-diagnostikuara, ose është i prirur për të sulmuar apo për t'u konfrontuar në mënyrë të dhunshme me oficerët e policisë.

Duhet pasur parasysh se në rastin e shtetasve të huaj që janë me qëndrim të përkohshëm, hetimi I së kaluarës, përfshirë edhe posedimin e armëve, mund të jetë e vështirë.

▼ KUJDES

Rreziku në incidentet e dhunës në familje është një kategori dinamike që mund të përshkallëzojë dhe të përkeqësojë me shpejtësi seriozitetin e situatës, çka mund të rrisë rrezikun për pasoja vdekjeprurëse, si për viktimën po ashtu edhe për oficerët e policisë që ndërhyjnë.

Duke pasur parasysh dinamikën komplekse të dhunës në familje, është e nevojshme të reagojmë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme ndaj të gjitha formave të dhunës në familje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në identifikimin e faktorëve me rrezik të lartë.

Rreziku rritet nëse:

- Autorët kanë një të kaluar me probleme mendore,
- Ka precedentë dhune dhe/ose raportime të mëparshme të dhunës,
- Ekzistojnë emocione ekstreme ose paqëndrueshmëri: Autorët shfaqin emocione ekstreme ose kanë sjellje të paqëndrueshme që mund të jetë e paparashikueshme dhe më e rrezikshme,
- Prania e fëmijëve në familje mund të rrisë rrezikun gjatë një incidenti dhune,
- Autori kërcënon se do të kryejë vetëvrasje,
- Procedurat gjyqësore, si p.sh. betejat ligjore të kujdestarisë, divorci ose lëshimi i urdhrave të mbrojtjes, mund të jenë faktorë që nxisin përshkallëzimin e dhunës,
- Ka shfaqje të xhelozisë ekstreme ose sjelljeve kontrolluese, duke përfshirë përndjekjen apo izolimin e viktimës,
- Abuzimi ose vrasja e kafshëve shtëpiake,
- Sjellja e autorit pëson ndryshime të papritura ose ekstreme,
- Autori ka kërcënuar se do e vrasë viktimën ose anëtarë të tjerë të rrethit të saj më të gjerë familjar,
- Viktima deklaron që ka frikë se autori mund ta vrasë, ose se mund të vrasë anëtarë të tjerë të rrethit të saj më të gjerë familjar, edhe pse autori nuk ka bërë kërcënime konkrete,
- Autori ka shkelur më parë ose vazhdon të shkelë masat/urdhrat e mbrojtjes,
- Ekzistojnë disa faktorë të kombinuar: p.sh. viktima raporton dhunë në familje për herë të parë; dhuna është përshkallëzuar gjatë vitit të fundit; viktima e ka braktisur abuzuesin.

HAPI 2:

Marrja e një raportimi për dhunë në familje

Oficerët e policisë në detyrë janë hallka e parë që marrin raportimin për dhunë. Për shkak të këtij pozicioni, ata luajnë një rol thelbësor në mbledhjen e informacionit me qëllim planifikimin e duhur të ndërhyrjes, marrjen në konsideratë dhe vlerësimin në kohë të rreziqeve të lidhura me armët e zjarrit, si dhe garantimin e sigurisë së viktimës dhe anëtarëve të tjerë të familjes të pranishëm gjatë incidentit, në veçanti të fëmijëve.

Ky informacion është gjithashtu thelbësor edhe për sigurinë e oficerëve të policisë që ndërhyjnë në rastet e raportuara të dhunës në familje, si dhe për sigurinë e profesionistëve të tjerë që mund të përfshihen. **Pas marrjes së raportimit, oficeri i policisë në detyrë duhet t'ja përçojë me kujdes të gjithë informacionin e mbledhur oficerëve që shkojnë në vendngjarje. Kjo garanton zbatimin e masave të ruajtjes së sigurisë personale, si dhe sigurinë e qytetarëve të pranishëm pas mbërritjes në vendngjarjes e incidentit.**

Gjithashtu, veprimet e para të oficerëve në detyrë mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në veprimet e mëtejshme të viktimës.

Për aq sa është e mundur, oficerët e policisë në detyrë duhet t'i kërkojnë personit që raporton dhunën, informacion mbi rrethanat e mëposhtme:

1. Ku ka ndodhur dhuna (adresa)?
2. A vazhdon dhuna në kohën e raportimit apo ka ndaluar?
3. Kush është personi me të cilin po bisedon (viktima, anëtar i familjes, dëshmitar...)?
4. Kush është viktima? A është viktima në rrezik imediat? Kush tjetër është i pranishëm gjatë incidentit? A ka fëmijë apo të moshuar të pranishëm?
5. A ka persona të lënduar? Nëse po, a është njoftuar institucioni përkatës shëndetësor?
6. Kush është autori i raportuar dhe a është aktualisht i pranishëm?
7. A është autori nën ndikimin e alkoolit apo opiateve?
8. A ka pasur precedentë të mëparshëm për dhunë?

Për sa u përket armëve të zjarrit, duhet të bëhen pyetjet në vijim:

1. A është përdorur një armë zjarri në incident? Nëse po, në çfarë mënyre?
2. Nëse është përdorur armë zjarri, duke përfshirë për kërcënim, ku gjendet tani arma e zjarrit?
3. A zotëron autori një ose disa armë zjarri? Ku mbahen këto armë zjarri?
4. Cili është profesioni i autorit?
5. A ka anëtarë të tjerë të familjes, veçanërisht ata që jetojnë në të njëjtën shtëpi, të cilët zotërojnë armë zjarri?

6. A e ka pasur raste të mëparshme kur autori e ka kërcënuar viktimën me armë zjarri, duke përfshirë në mënyrë verbale?

▼ KUJDES

Në rastet kur viktimat përballen me rrezik të menjëhershëm, kur dhuna vazhdon ose kur personi që raporton nuk është i gatshëm apo në gjendje që t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve të renditura, oficeri i policisë në detyrë do të prioritizojë pyetjet lidhur me vendngjarjen e incidentit dhe rreziqet specifike me të cilat përballlet viktimat.

▲ KËSHILLAT LIDHUR ME SIGURINË

Në rast se në incident janë përdorur armë zjarri ose ka rrezik të pashmangshëm të përdorimit të tyre, viktimat duhet të këshillohet që:

- a. të qëndrojnë në një dhomë apo ambient me dalje të aksesueshme, mundësisht në katin përdhes,
- b. të mos qëndrojnë në dhoma pa dalje dhe në ambiente ku mund të ketë armë zjarri apo lloje të tjera armësh, si p.sh., në kuzhinë, banjë apo garazh,
- c. të qëndrojnë në një dhomë ku ka telefon, për të kontaktuar policinë, një mik apo fqinjët.
- d. shmang përballjen me dhunuesin.

Këshillat e mësipërme të lidhura me sigurinë duhet t'u jepen viktimave në të gjitha rastet dhe jo vetëm nëse është përdorur një armë zjarri ose nëse ekziston një rrezik i lartë i përdorimit të një arme zjarri. Për më tepër, është e nevojshme t'u rekomandohet viktimave që ta regjistrojnë numrin e policisë në funksionin e "thirrjes së shpejtë" dhe ta mbajnë vazhdimisht të karikuar baterinë e telefonit.

Është e nevojshme që të informohen viktimat rreth ndihmës së specializuar dhe shërbimeve mbështetëse që ofrohen për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje (nëse ka shërbime të tilla) dhe të zhvillohet një plan i përgjigjes së shpejtë së bashku me viktimat. Për shembull, palët mund të bien dakord për një fjalë ose frazë që mund të përdoret nga viktimat gjatë komunikimit me një shërbim të specializuar, çka do të sinjalizonte shërbimin e specializuar që të kontaktonte menjëherë policinë dhe t'i shpjegonte në detaje vendndodhjen e viktimës, si dhe faktin nëse rasti përfaqëson një rrezik të lartë.

HAPI 3:

Vlerësimi i rreziqeve

Në kontekstin e dhunës në familje, armët përbëjnë **një rrezik të shumëfishtë sigurie**. Gjatë vlerësimit të rrezikut ose ndërhyrjes, punonjësit e policisë duhet të kenë parasysh situatat e mëposhtme, veçanërisht nëse:

- a. **Autori ose një tjetër anëtar i familjes (duke përfshirë viktimën) zotëron armë në mënyrë të ligjshme,**
- b. **Autori ose një tjetër anëtar i familjes zotëron armë në mënyrë të jashtëligjshme,**
- c. **Autori ka akses në armë zjarri si pasojë e detyrës së tij dhe është i trajnuar për përdorimin e tyre,**
- d. **Dhunuesi mund të zotërojë lehtësisht një armë,**
- e. **Autori kërcënon se do të përdorë armë zjarri,**
- f. **Treguesit vizualë të zotërimit të (jashtë)ligjshëm të armëve të zjarrit,**
- g. **Më parë, ka pasur ndërhyrje të policisë në të njëjtën adresë ose ndërhyrje të lidhura me të njëjtët persona.**

Vlerësimi i ekzistencës së ndonjërit prej këtyre rreziqeve kryhet nga oficeri i policisë në detyrë (ose një oficer tjetër i caktuar i policisë) **menjëherë** pas marrjes së raportimit për dhunë në familje. Vlerësimi kryhet për çdo rast të raportuar të dhunës në familje dhe është thelbësor për planifikimin e ndërhyrjes. Është gjithashtu e nevojshme të shqyrtohen skenarët e mundshëm që mund të çojnë në një përshkallëzim të dhunës, duke përfshirë reagimet ndaj ndërhyrjes së policisë. **Informacionet me rëndësi sigurohen nga të gjitha burimet e disponueshme të të dhënave, duke përfshirë nga bazat përkatëse të të dhënave të Ministrisë së Brendshme (MB-së)/Policisë dhe regjistrat operacionalë të policisë.** Ky verifikim duhet të kryhet me shpejtësi dhe paralelisht me planifikimin e ndërhyrjes, pasi reagimi i shpejtë dhe i sigurt ka rëndësi thelbësore.

Më poshtë, shtjellohet më në detaje çdo rrezik specifik.

A) Autori ose një tjetër anëtar i familjes zotëron armë në mënyrë të ligjshme

Pas marrjes së raportimit për dhunë në familje, oficeri në detyrë verifikon sa më poshtë:

- ▶ A ka autori armë zjarri në zotërim të ligjshëm, të regjistruara në regjistrin e armëve të zjarrit të MB-së?
- ▶ A ka autori armë zjarri në zotërim të ligjshëm, të regjistruara në regjistrin e armëve të zjarrit të MB-së, por arma e zjarrit është konfiskuar, është raportuar si e humbur ose e vjedhur, apo është shitur?

- ▶ A ka ndonjë prej anëtarëve të tjerë të familjes armë zjarri në zotërim të ligjshëm?
- ▶ A ka humbur jetën ndonjë prej anëtarëve të familjes që ka pasur në pronësi armë zjarri? Nëse po, kërkoni informacion për çdo armë zjarri,
- ▶ A është konfiskuar ndonjë armë zjarri në zotërim të autorit apo të ndonjë anëtari tjetër të familjes? Verifikoni nëse armët e zjarrit janë kthyer.

▼ KUJDES

Në disa raste, bazat ekzistuese të të dhënave për armët e zjarrit mund të mos ofrojnë të dhëna të përditësuara mbi pronësinë e armëve të zjarrit, ose të dhënat mund të mos jenë të aksesueshme në çdo moment (24/7) nga oficerët e policisë që u përgjigjen rasteve të dhunës në familje.

B) Autori ose një tjetër anëtar i familjes zotëron armë në mënyrë të jashtëligjshme

Kur vlerësohet nëse autori apo ndonjë anëtar tjetër i familjes, përfshirë viktimën e dhunës në familje, mund të kenë ose jo armë zjarri në zotërim të jashtëligjshëm, ekzistojnë disa rrethana që mund të shërbejnë si tregues apo që mund të ngrenë dyshime. Në rast të pranisë së ndonjë prej treguesve të mëposhtëm, ata duhet të merren në konsideratë dhe të verifikohen pa përjashtim nga një oficer i caktuar i policisë.

Për të vlerësuar nëse autori mund të ketë armë zjarri në zotërim të jashtëligjshëm, duhet të merret në konsideratë sa më poshtë:

- ▶ Viktima dyshon se autori ka armë zjarri në zotërim të jashtëligjshëm ose ka akses në një armë të tillë,
- ▶ Informacionet, duke përfshirë shkëmbimet e informacionit me oficerët e tjerë të policisë, tregojnë se autori mund të ketë një apo disa armë zjarri/lëndë plasëse në zotërim të jashtëligjshëm,
- ▶ A ka ndonjë tregues se autori mund të zotërojë apo të ketë akses në armë zjarri për shkak të profesionit aktual apo të mëparshëm (p.sh., është oficer policie ose pjesëtar i personelit ushtarak, apo një punonjës i një institucioni tjetër që lejohet të mbajë armë, si p.sh., i Shërbimit të Inteligjencës, Policisë Gjyqësore, doganave, shërbimeve korrigjuese, apo rojtar i pyjeve, punonjës sigurie i bankave, ose kurator muzeu etj., punonjës i një shoqërie private të sigurisë, punonjës në dyqan armësh zjarri, punonjës i shërbimit të

mbrojtjes së tokave bujqësore apo mbikëqyrës i veprimtarive sportive/të gjuetisë)?

- ▶ A ka ndonjë tregues se autori mund të zotërojë apo të ketë akses në armë zjarri për shkak të pjesëmarrjes së tij në konflikte të armatosura apo jetesës në një zonë ku kanë ndodhur konflikte të armatosura?
- ▶ A janë ngritur më parë akuza ndaj autorit për vepra penale lidhur me zotërimin e jashtëligjshëm apo trafikimin e armëve, ose me ndonjë shkelje të kërkesave ligjore të lidhura me zotërimin dhe mbajtjen e armëve, duke përfshirë akuza për kundërvajtje? A është dënuar apo gjobitur autori për të shtëna gjatë festimeve? Të gjitha akuzat duhet të merren në konsideratë edhe nëse nuk kanë rezultuar në dhënien e një dënimi.
- ▶ A i është refuzuar ndonjëherë autorit aplikimi për leje për armë zjarri?
- ▶ Të verifikohet historiku i mëparshëm i autorit (dosjet dhe të dhënat penale të mëparshme, anëtarësimi në grupe kriminale apo të qenit person me interes për policinë, çdo informacion që ngre dyshime për zotërim të jashtëligjshëm të armëve, si dhe nëse e ka përmendur në prani të personave të tjerë se do të përdorë armë kundrejt gruas/viktimës etj.).

Cilido nga treguesit e mësipërm duhet të merret plotësisht në konsideratë dhe të verifikohet më tej. Duke pasur parasysh seriozitetin e rrezikut të dhunës në familje, të dhënat që nuk janë menjëherë të disponueshme duhet të mblidhen sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të planifikohet një ndërhyrje në kohën e duhur.

▼ KUJDES

Edhe pse viktima mund të përbëjë një burim të rëndësishëm informacioni lidhur me armët e zjarrit që mund të jenë në zotërim të jashtëligjshëm, duhet të merren në konsideratë aspektet e mëposhtme:

- Viktimat ose personat e tjerë që raportojnë dhunën mund të mos jenë në dijeni të pranisë së armëve të zjarrit,
- Viktimat mund të mos jenë të gatshme të raportojnë për zotërimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit për shkak të frikës nga pasojat dhe hakmarrja,
- Viktimat mund të mos jenë në gjendje të japin informacionet e mësipërme, veçanërisht në situata që përfshijnë rrezik serioz dhe të pashmangshëm ndaj jetës së tyre.
- Viktima mund të mos e perceptojë plotësisht rrezikun që paraqet prania e një arme dhe mund të mos e raportojë këtë fakt sepse e konsideron të parëndësishëm.

Është e nevojshme që punonjësit e policisë të mbledhin:

- Njohuri operacionale në terren
- Informacion nga shërbimet e specializuara të ndihmës dhe mbështetjes nëse viktimat u drejtohet atyre për ndihmë
- Informacion nga një person i besuar, nëse viktimat ka një

Kutia 2: Teknologjitë e reja - Printimi 3D

Aksesi i autorit në teknologji të reja që mundësojnë, për shembull, printimin e armëve në formatin tre dimensional (3D), mund të përbëjë një rrezik të konsiderueshëm. Printimi 3D, i njohur gjithashtu si prodhim nëpërmjet vendosjes së shtresave, është një teknologji përmes së cilës shtresat e materialit vendosen mbi njëra-tjetrën nën kontrollin e kompjuterit për të krijuar një objekt tre dimensional.

Gjatë kohëve të fundit, printerët 3D janë bërë gjithnjë e më të disponueshëm në treg dhe përdoren në industri të ndryshme, duke përfshirë në industrinë e automjeteve, aeronautikës, arkitekturës, mbrojtjes dhe pajisjeve mjekësore. Gjatë viteve të fundit, termi “printim 3D” është bërë i njohur si një metodë relativisht e thjeshtë për prodhimin e armëve të zjarrit, çka rrit shqetësimet që kjo metodë mund të çojë në rritjen e përhapjes së armëve të zjarrit, në rritjen e numrit të shkeljeve të sigurisë dhe madje mund të nxisë edhe terrorizmin.

Duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë së printimit 3D, uljen e çmimeve të printerëve 3D dhe materialeve përkatëse të konsumueshme, si dhe hedhjen në treg të materialeve të reja dhe të përmirësuara, është thelbësore që institucionet përkatëse të jenë të informuara rreth mundësive që paraqet kjo teknologji dhe të monitorojnë situatën me qëllim që të reagojnë në kohën e duhur. Zhvillimi i printerëve 3D përfshin një sërë sfidash, si p.sh., kontrolli i prodhimit të paautorizuar të armëve të zjarrit, zbatimi i kufizimeve të vendosura mbi skedarët dixhitalë për armët e zjarrit në internet, zbulimi dhe gjurmimi i armëve të zjarrit të printuara në 3D, zbatimi i kufizuar i teknikave të kriminalistikës etj.

C) Autori ka akses në armë zjarri si pasojë e detyrës së tij dhe është i trajnuar për përdorimin e tyre

- ▶ A është i autorizuar autori për të pasur akses në një armë zjarri si pasojë e profesionit të tij aktual apo të mëparshëm (p.sh., është oficer policie ose pjesëtar i personelit ushtarak, apo një punonjës i një institucioni tjetër që lejohet të mbajë armë, si p.sh., i Shërbimit të Inteligjencës, Policisë Gjyqësore, doganave, shërbimeve korrigjuese, apo rojtar i pyjeve, punonjës sigurie i bankave, ose kurator muzeu etj., punonjës i një shoqërie private të sigurisë, punonjës në dyqan armësh zjarri, punonjës i shërbimit të mbrojtjes së tokave bujqësore apo mbikëqyrës i veprimtarive sportive/të gjuetisë)?
- ▶ A është autori anëtar i një shoqate gjuetie apo të qitjes sportive?
- ▶ A ka ndonjë tregues se autori mund të zotërojë ose të ketë akses në armë për shkak të përfshirjes së tij në një veprimtari argëtuese të caktuar (gjuajtje me hark, gjueti ose veprimtari të ngjashme)?
- ▶ A ka autori autorizim për të mbajtur armën e zjarrit të shërbimit si pjesë e detyrave të tij zyrtare?

D) Autori kërcënon me përdorimin e armës

- ▶ Autori e ka kërcënuar më parë viktimën se do të përdorë armë zjarri;
- ▶ Autori e ka kërcënuar viktimën gjatë incidentit të raportuar se do të përdorë armë zjarri;
- ▶ Në bazë të informacionit operacional, autori i ka treguar një personi tjetër se do të përdorë armë zjarri kundrejt viktimës, ose e ka kërcënuar viktimën përmes një personi tjetër;
- ▶ Autori e ka kërcënuar viktimën në prani të oficerëve të policisë;
- ▶ Autori kërcënon me vetëvrasje;
- ▶ Kërcënimi me armë zjarri mund të përfshijë gjithashtu nxjerrjen e armës së zjarrit për të ngjallur frikë te viktimja;
- ▶ Historiku i mëparshëm i autorit (dosjet dhe të dhënat penale të mëparshme, anëtarësimi në grupe kriminale apo të qenit person me interes për policinë, informacionet operationale që ngrenë dyshime për zotërim të jashtëligjshëm të armëve, si dhe nëse e ka përmendur në prani të personave të tjerë se do të përdorë armë kundrejt gruas/viktimës etj.).

E) Treguesit vizualë të zotërimit të (jashtë)ligjshëm të armëve të zjarrit

Krahas treguesve të sipërpërmendur, gjatë ndërhyrjes duhet t'i kushtohet vëmendje pranisë së objekteve/treguesve në vijim, të cilët mund të shërbejnë si indikatorë se autori zotëron armë zjarri të (jashtë)ligjshme ose ka akses në armë zjarri:

1. Municione ose paketim të municioneve



Source: SEESAC

2. Kasafortë/pajisje për kyçjen e armëve



Source: Shutterstock

3. Krehra armësh



Source: Shutterstock

4. Trofe nga gjuetia ose aktivitetet e qitjes sportive



Source: iStock

5. Vaj për pastrimin e armëve ose mjete pastrimi



Source: Shutterstock

6. Instrumente për rimbushjen e armëve




Source: Shutterstock

7. Vrima plumbash në pemët apo në pllakat në oborr



Source: Shutterstock

8. Tabela qitjeje



Source: Shutterstock

▼ KUJDES

Në rast se armët e zjarrit në pronësi të ligjshme të autorit janë konfiskuar, sigurohuni që të verifikoni nëse është dhënë ndonjë vendim për rikthimin e këtyre armëve të zjarrit dhe rrjedhimisht, nëse ato i janë rikthyer autorit.

Kutia 3: Kontrolli i mediave sociale dhe aktivitetit në internet

Llogaritë e autorit në media sociale mund të sigurojnë të dhëna rreth përdorimit të mundshëm të armëve të zjarrit. Duhet t'i kushtohet vëmendje çdo veprimtarie që mund të ngrejë dyshime.

Për sa i përket pranisë në media sociale dhe aktivitetit në internet, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë çdo përmbajtjeje që:

- Nxit dhe vlerëson dhunën në çdo kontekst,
- Përmban qëndrime mizogjene, gjuhë urrejtjeje ndaj grave dhe vajzave, ose paragjykime të tjera të shprehura fuqishëm ndaj grave,
- Justifikon dhunën ose bën thirrje për dhunë ndaj grave dhe vajzave dhe dhunë me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën, ngacmimin dhe abuzimin seksual,
- Ka qëndrime pozitive ndaj të shtënave masive, duke përfshirë postime për autorët e të shtënave masive në të shkuarën,
- Përmban gjuhë urrejtjeje apo qëndrime të dhunshme ndaj grupeve të caktuara të kategorizuara, për shembull, sipas përkatësisë etnike, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës, fesë,
- Tregon përfshirje në bullizëm kibernetik dhe/ose ngacmim në internet/krim kibernetik,
- Tregon lidhje me banda,
- Tregon radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm,
- Promovon dhunën në aktivitete sportive,
- Promovon drejtimin e rrezikshëm ose të pakujdesshëm të automjetit,
- Tregon mizori ndaj kafshëve.

HAPI 4:

Ndërhyrja dhe siguria

A) Garantimi i sigurisë personale dhe sigurisë së viktimave

Oficerët e policisë që marrin pjesë në ndërhyrje janë të detyruar të ndalojnë dhunën, në rastet kur ajo vazhdon, të ndajnë viktimën nga autori, të eliminojnë çdo rrezik të menjëhershëm ndaj viktimës dhe të parandalojnë çdo akt të mëtejshëm dhune.

Kur ka tregues të zotërimit apo të aksesit në armët e zjarrit në incidentin e raportuar, oficerët e policisë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e tyre, sigurinë e viktimave dhe të personave të tjerë.

Krahas procedurave standarde të veprimit që zbatohen në situata specifike, për sa u përket armëve të zjarrit duhet të merren masat e sigurisë në vijim:

- Nëse ka tregues se autori është i armatosur, në kohën e mbërritjes në vendngjarjen e incidentit, oficerët e policisë duhet të vëzhgojnë dhe të vlerësojnë situatën me qëllim që të zgjedhin mënyrën më të sigurt dhe më efektive për të hyrë në vendngjarje dhe për të neutralizuar rrezikun që vjen nga autori. Ata nuk duhet të shkojnë asnjëherë direkt në vendngjarje pa përcaktuar fillimisht se kush është autori i mundshëm dhe pa identifikuar rreziqet e mundshme ndaj sigurisë së oficerëve të policisë. Gjatë dërgimit të një patrulle, grupi i punës në i detyrë është i detyruar të vazhdojë të kryejë të gjitha kontrollet e nevojshme në dispozicion në regjistrat që ka në dispozicion dhe të informojë oficerët e dërguar në lidhje me rezultatet pa pasur vonesa.
- Gjatë ndërhyrjes së policisë, nëse një nga oficerët e policisë konstaton se një person ka armë zjarri, ai/ajo duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të garantuar sigurinë personale dhe të individëve të tjerë të pranishëm.
- Autori i armatosur duhet të mbahet nën vëzhgim të vazhdueshëm gjatë ndërhyrjes.
- Gjatë kontaktit me personin, oficeri i policisë duhet ta marrë personalisht armën dhe ta sigurojë atë në mënyrë të tillë që të ruhet në cilësinë e provës, duke pamundësuar kështu kontaktin e autorit me armën. Oficeri i policisë duhet të kontrollojë personin (autorin) për fshehje të armëve të tjera. Nëse autori dërgohet në stacionin e policisë, duhet të kryhet një kontroll në mënyrë që ai/ajo të mos fshehë armë në rrobat e tij/saj.

B) Sigurimi dhe mbledhja e gjurmëve të akteve kriminale dhe e armëve të zjarrit

Në rastet kur ka pasur përdorim të armës së zjarrit (ose kur arma e zjarrit është objekti i veprës penale), zbatohen procedurat standarde të veprimit për këqyrjen e vendngjarjes. Është thelbësore që të evitohet kontaminimi i provave. Ekipi i këqyrjes së vendngjarjes duhet të shkojë në vendngjarje dhe të kryejë një hetim për të zbuluar, regjistruar, fiksuar dhe mbledhur të gjitha gjurmët që janë thelbësore për hetimin. Nëse është e nevojshme, vendosni një perimetër sigurie deri në mbërritjen e një ekipi të specializuar.

C) Konfiskimi i armëve të zjarrit

Në rastet kur nuk ka pasur përdorim të armës së zjarrit, oficerët e policisë, duke vepruar mbi bazën e çdo raportimi të dhunës në familje (pavarësisht rezultatit), do të veprojnë gjithmonë si më poshtë:

- **Do të sekuestrojnë të gjitha armët e zjarrit, municionet dhe lejet për armë zjarri nga të gjithë personat e përfshirë në incident (pavarësisht nëse janë viktima apo autorë), si dhe nga anëtarët e familjes si dhe nga personat që jetojnë apo qëndrojnë në banesën e autorit apo viktimës (pra që ndajnë të njëjtën shtëpi, pavarësisht vendbanimit zyrtar),**
- **Në rast se ndonjë nga pjesëmarrësit në incident zotëron një armë që gjendet në një vendndodhje tjetër, do të nisë menjëherë veprimtaria për lokalizimin dhe të ndër marrë masa dhe veprime për sekuestrimin e kësaj arme zjarri.**
- **Do të konfiskojnë të gjitha armët e zjarrit në zotërim të jashtëligjshëm dhe do të ngrenë akuza penale për veprën penale përkatëse.**

Kur autori i një incidenti të dhunës në familje është një oficer policie, pjesëtar i personelit ushtarak apo një punonjës tjetër i autorizuar për të mbajtur armë zjarri, do të sekuestrohet menjëherë arma personale e zjarrit në pronësi të këtij personi. Gjithashtu, eprori i tij i drejtpërdrejtë do të sekuestrojë përkohësisht edhe armën e shërbimit, në mënyrë të menjëhershme.

D) Armët e zjarrit në zotërim të jashtëligjshëm

Kur ka indicie dhe dyshime të arsyeshme nga oficerët e policisë se, gjatë ndërhyrjes, personi i raportuar për dhunë në familje ose një nga anëtarët e familjes mund të zotërojnë një armë të jashtëligjshme, ata marrin menjëherë dhe pa asnjë vonesë të gjitha masat për gjetjen e armës, si dhe kryejnë **një kontroll sipas procedurave të zbatueshme. Oficerët e policisë do t'i koordinojnë këto masa me prokurorinë përkatëse.**

Këtu përfshihen gjithashtu situatat kur informacioni mbi mundësinë e zotërimit të armëve të zjarrit të jashtëligjshme merret nga viktimat, anëtarët e familjes apo persona të tjerë, duke përfshirë fqinjët.

Kur ka tregues të zotërimit të jashtëligjshëm të armëve, oficerët e policisë marrin fillimisht masa për sigurinë e tyre personale, si dhe për sigurinë e viktimës dhe të personave të tjerë.

Më pas, oficerët e policisë marrin masat në vijim:

- Realizohet një mbikëqyrje dhe kontroll i menjëhershëm mbi personin që mendohet se zotëron armë,
- Ky person duhet të qëndrojë me oficerët e policisë dhe nuk mund të largohet apo të lëvizë i pashoqëruar nëpër godinë, shtëpi ose apartament,
- Personat, prania e të cilëve nuk është e domosdoshme, do të largohen nga objekti apo ambienti,
- Asnjë person i paautorizuar nuk duhet të lejohet të hyjë në objektin apo zonën ku duhet të kryhet kontrolli,
- Kontrolli do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe me procedurat që zbatohen rregullisht në situata të tilla,
- të mbledhin deklaratat nga anëtarët e familjes për zotërimin dhe praninë e mundshme të armëve.

Oficerët e policisë i marrin këto masa edhe në situatat kur një person ka një armë në zotërim të ligjshëm, e cila duhet të konfiskohet, por personi:

- deklaron se nuk e di vendndodhjen e saj,
- deklaron se arma është vjedhur, por nuk e ka raportuar këtë fakt,
- nuk jep informacion lidhur me vendndodhjen e armës.

Në raste specifike, kur ka baza të arsyeshme për praninë e armëve të zjarrit të jashtëligjshme, mund të kërkohet mbështetja e njësive të qenve K9 ose mund të merret në konsideratë përdorimi i një detektori elektronik.

▼ KUJDES

Përpara administrimit të armës, pavarësisht nëse ajo është gjetur në vendngjarje, në zotërim të një personi ose përmes marrjes së masave të tjera, duke përfshirë përmes sekuestrimit, pas fiksimit të duhur të gjurmëve, është e detyrueshme që arma të trajtohet si e mbushur dhe gati për qitje. Për rrjedhojë, duhet të hiqet krehri me municione, kur është e mundur, të kontrollohet përmbajtja e folesë dhe vetëm pasi të jetë përcaktuar pa asnjë dyshim se arma nuk është e mbushur, oficerët e policisë mund të vijojnë me administrimin e mëtejshëm të saj.

Në rast të revokimit të licencës së armëve të zjarrit, mund të jenë të nevojshme hapa të menjëhershëm për të mbrojtur partneren/in e mbajtësit të licencës ose aplikantit të armës së zjarrit nga hakmarrja.

E) Prania e lëndëve plasëse dhe e pajisjeve shpërthyese

Në rastin e identifikimit të objekteve të dyshimta që mund të konsiderohen pajisje shpërthyese, ato nuk duhet të preken në asnjë mënyrë, por duhet të raportohen menjëherë tek autoritetet kompetente operacionale në detyrë dhe të kërkohet asistencë e njësisë përkatëse xheniere.

HAPI 5:

Zhvillimet pas incidentit: Procedurat lidhur me armët e zjarrit

Pas sequestrimit, armët e zjarrit depozitohen në një dhomë të ruajtjes së provave në polici ose në një vendndodhje tjetër të përcaktuar.

Nëse një person i raportuar për dhunë në familje disponon leje për armë zjarri dhe arma e tij/e saj e zjarrit sequestrohet përkohësisht gjatë kryerjes së procedurave të lidhura me raportimin e dhunës në familje, **përshtatshmëria e tij/saj për të mbajtur leje për armë zjarri do t'i nënshtrohet një rishikimi të nevojshëm për të garantuar pajtueshmëri të plotë me kriteret e kualifikueshmërisë të parashikuara në ligjin “Për armët”. Ky rishikim do të nisë pas çdo raportimi për sjellje të dhunshme, ose nëse ka dyshime të arsyeshme për keqpërdorim të armëve të zjarrit.**

Duke qenë se ligji “Për armët” parashikon se për të pasur leje për armë zjarri, nuk duhet të ketë asnjë tregues se sjellja e personit mund të përbëjë rrezik për atë vetë apo për persona të tjerë dhe për rendin dhe qetësinë publike, si dhe nuk duhet të ketë asnjë tregues se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, **duhet të lëshohet një vendim për revokimin e lejes për armë zjarri me qëllim zbutjen e rreziqeve në mënyrë efektive dhe parandalimin e çdo rasti të mëtejshëm, përsëritjes apo përshkallëzimit të dhunës në familje ose çdo lloj forme tjetër dhune.**

▼ KUJDES

Kur vlerësoni pranueshmërinë e mbajtësit të lejes së armës së zjarrit për të vazhduar të mbajë një licencë, mos harroni se pronësia e armëve të zjarrit është një mundësi e parashikuar nga ligji, e cila mbart me vete një sërë detyrimesh të përcaktuara rreptësisht.

Vendimi duhet të marrë në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse që mund të përbëjnë indicie për keqpërdorim të mundshëm të armëve të zjarrit, duke përfshirë: përfundimet e incidentit të raportuar të dhunës në familje, faktin nëse janë ngritur akuza penale ose për kundërvajtje, nëse janë iniciuar apo do të iniciohen procedime ndaj autorit, nëse po ndërmerren masa emergjence dhe masa të tjera mbrojtëse dhe cilat konkretisht, nëse këto masa janë në fuqi, nëse masat e emergjencës dhe masat e tjera mbrojtëse janë shkelur dhe cilat konkretisht, nëse ka informacione operacionale lidhur me shkeljen e masave që nuk janë raportuar apo përpunuar, qëndrimin e viktimës dhe anëtarëve të familjes lidhur me zotërimin e armëve, nëse ata janë dakord, nëse shprehin shqetësim apo frikë gjatë marrjes në pyetje për këtë çështje, apo përshtypje të tjera personale të oficerëve të policisë që tregojnë se këta persona janë të frikësuar apo kanë shqetësime të tjera lidhur me këtë çështje, raportin aktual midis mbajtësit të lejes dhe viktimës, sjelljen e kandidatit pas raportimit të dhunës, në veçanti gjatë diskutimit

të dhunës së raportuar, rreziqet e identifikuara pas raportimit të dhunës, opinionin e oficerit kompetent të policisë në detyrë apo policimit në komunitet.

▼ KUJDES

Vendimet me nivelet më të larta të rrezikut përfshijnë:

- Vendimet e dhëna për mosrevokim të lejes pas një rishikimi të përshtatshmërisë të iniciuar për shkak të një incidenti. Këtu përfshihen rastet kur armët e zjarrit janë sekuestruar për të mundësuar kryerjen e hetimeve dhe më pas është marrë vendim për rikthimin e tyre tek autori.
- Vendimet për miratim apo rinovim të lejes kur ka prova të dhunës, abuzimit në familje, gjendjes mjekësore të papërshtatshme, apo kur janë ngritur shqetësime nga një i njohur i mbajtësit të lejes, por aplikanti është vlerësuar si i përshtatshëm.

Bazuar në përfundimet e një raporti gjithëpërfshirës, vendimet e mëtejshme mbi armët e zjarrit do të merren nga departamenti administrativ përkatës. Ky departament duhet të informojë oficerët e policisë që janë përfshirë në përgjigjen ndaj incidentit lidhur me rezultatin e vendimit. Gjithashtu, mund të duhet të merren hapa aktivë për të mbrojtur nga hakmarrja partnerin/partneren e personit të pajisur me leje, si pasojë e revokimit të lejes.

Kjo është tejet e rëndësishme, pasi ka një sërë rrethanash që mund ta shtyjnë autorin të keqpërdorë armën e zjarrit pas incidentit të dhunës në familje. Rrethanat në vijim mund të kërkojnë vëmendjen e oficerëve të policisë.

Rrethanat që kërkojnë masa paraprake

1. E mbijetuara e dhunës në familje po ndahet nga autori ose është ndarë së fundmi (jo më shumë se 1 vit më parë),
2. Një grua që ka qenë viktimë e dhunës në familje po nis procedurat e divorcit,
3. Një grua që ka qenë viktimë e dhunës në familje po nis/negocion procedurat për kujdestarinë, për të drejtat e takimit të fëmijëve, ose ekziston një konflikt mbi të drejtat e takimit/kujdestarinë e fëmijëve, duke përfshirë mosrespektimin e vendimit të kujdestarisë,
4. Një grua që ka qenë viktimë e dhunës në familje po nis/negocion procedurat lidhur me detyrimin financiar për fëmijët,

5. Një grua ka një partner të ri.
6. Një grua që ka pësuar dhunë në familje ndryshon vendin e saj të banimit.
7. Një grua që raporton ndjekjen ose ngacmimin nga autori i krimit, duke përfshirë mesazhet e padëshiruara, telefonatat apo mediat sociale.
8. Gruaja raporton se partneri i saj këmbëngul për të vazhduar jetën e tyre së bashku dhe shfaq sjellje xheloze,
9. Një grua shpreh frikë ose shqetësim për sigurinë e saj ose sigurinë e fëmijëve të saj ose anëtarëve të tjerë të familjes.

Pas incidentit të dhunës në familje, është e nevojshme t'u kushtohet vëmendje e veçantë rasteve kur ndaj autorit është lëshuar një urdhër i përkohshëm mbrojtjeje, veçanërisht nëse ky urdhër lidhet me sekuestrimin e armës.

Për ta përmbyllur, oficerët e policisë që u përgjigjen rasteve të dhunës në familje janë thelbësorë në dokumentimin e incidenteve të dhunës në familje dhe të masave të marra në rastet e pranisë/keqpërdorimit të një arme zjarri. Për rrjedhojë, raportimi i kujdesshëm dhe i rregullt mbi këto raste është thelbësor për ta vënë autorin përpara përgjegjësisë dhe për të parandaluar akte të mëtejshme dhune.

- I** Përkufizimet në këtë kapitull janë marrë nga Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".
- II** Për më shumë informacion, shihni Raportin kryesor të Anketës së udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave ([OSCE-led Survey on Violence Against Women - Main Report](#)). Ky raport prezanton gjetjet e krahasueshme ndër-rajonale të Anketës së OSBE-së për mirëqenien dhe sigurinë e grave, e cila u realizua në vitin 2018 në juridiksione të përzgjedhura të Evropës Lindore dhe Juglindore. Anketa e udhëhequr nga OSBE përfshinte një komponent sasior dhe cilësor dhe u realizua me qëllim sigurimin e të dhënave të krahasueshme rreth formave të ndryshme dhunës së përjetuar nga gratë gjatë fëmijërisë dhe jetës së tyre. Studimi ekzaminoi dhunën që përjetojnë gratë në mjediset me konflikt dhe pa konflikt, si dhe ndikimin që ka dhuna te gratë dhe vajzat, duke përfshirë pasojat afatgjata të saj. Të anketuarit u pyetën rreth normave dhe qëndrimeve të lidhura me dhunën ndaj grave me qëllimin për të kuptuar më mirë shkaqet që qëndrojnë në themel të dhunës.
- III** SecuriMeter 2023–Anketimi i opinionit publik rreth sigurisë, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, 2023.
- IV** SecuriMeter 2022–Anketimi i opinionit publik rreth sigurisë, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.
- V** Burimi: Gjinia dhe armët e vogla në Evropën Juglindore, SEESAC, 2016.
- VI** Analizë e rasteve të vrasjeve të grave të kryera me armë zjarri (Qershor 2017 – Qershor 2020). UNDP Serbi, 2021.
- VII** Po aty.
- VIII** Një udhëzues drejtuar Policisë për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të dhunës ndaj grave të ushtruar nga partneri intim, Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, 2019.

CIP - Каталогизacija y publikaciji
Народна библиотека Србије, Београд

343.54./55
623.44

UDHËZUES për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje / [redaktorët Jasminka Frishchikj, Dragan Božanić]. - Beograd : UNDP SEESAC, 2024 (Belgrad : Bigraf plus). - 48 str. : ilustr. ; 30 cm

Prevedeno prema: Smernice za procenu i odgovor na rizike u vezi sa zloupotrebom vatrenog oružja u nasilju u porodici. - Tiraž 50.

ISBN 978-86-7728-367-4

- a) Породично насиље
- б) Ватрено оружје -- Злоупотреба

COBISS.SR-ID 144428809



South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse
for the Control of Small Arms and Light Weapons (SEESAC)

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000 Belgrade, Serbia

Tel: +381 11 415 5300

E-mail: seesac@undp.org

www.seesac.org



Funded by
the European Union

Working within the framework of:

